



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	07.06 2025	
Priljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-111/01-15326		



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Nr:

Datë:

Bazuar në Ligjin për Zyrat e Publikë Nr. 06/L-197, Kapitulli V neni 80 dhe 81, nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorëve dhe zv. Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Përsonelet të shërbimeve të përbashkëta në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, NjMBNj, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendeve të punës:

- Drejtor në SHMP "A. Gllavica në Lipjan
- Drejtor në SHFMU "17 Shkurti" në Glllogovc

Institucioni: **Komuna e Lipjanit**

Departamenti/Drejtoria: **Drejtoria e Arsimit**

Lloji i pozitës: **Jo karrierës**

Numri i pozitave: **Dy (2)**

Titulli i mbikëqyrësit: **Drejtori i DKA-së**

Grada e Koeficientit: **6.8 dhe 6.7**

Orët e punës: **40**

Kohëzgjatja e emërimit: **4 vite**

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionet edukativo arsimore.

Detyrat Kryesore:

- Përgatitja e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimi i sistemit të informatave për menaxhimin e dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura me praktikës, sigurimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kulikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës aktiviteve profesionale dhe bashkëpunorëve profesional të institucionit edukativo arsimor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin e mësimdhënësve, disiplinën në institucionin arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të Shkollë, Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo arsimor;
- Raporton dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo arsimor, duke përfshirë edhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve;
- Ruajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave siç parashihet nga komuna dhe MASHT;
- Çështjet tjera që rregullohen përmes këtij ligji dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit:
 1. Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi prej 330 ECTS, me së paku pesë (5) vite të shkollimit universitar);
 2. Master arsimor, kualifikimi 300 ECTS, 5 vite të shkollimit universitar;
 3. Fakulteti katër vjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, katër (4) vite të shkollimit universitar);
 4. Bachelor katër vjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, katër (4) vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas UA për licencimin e mësimdhënësve;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim të aprovuar nga MASHT sipas rekomandimit të KSHL;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
 1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë.
 2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në SHFMU;
 3. Tre (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor.

Dokumentet e nevojshme:

- Certifikata e lindjes;
- Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshmi se nuk është nën hetime dhe dëshmia se nuk ka qenë i/e dënuar për krim dhune ose vepra të pa denja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo - arsimor dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar, koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë së paku 10 faqe tekst (një faqe për një fushë) me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12 Arial, sipas udhëzimeve të MASHT-it;
- Letrat e referencë duhet të kenë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimin paraprak nga institucion publik kredibil (MASHT, DKA, Këshilli i Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë);
- Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon;
- Portofolin profesionale;
- Kopjen e letërnjoftimit.
- CV dhe
- Deklaratën nën betim

Afati dhe mënyra e aplikimit: Konkursi mbetet i hapur 30 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 08.04.2025 deri 07.05.2025 (15:00).

Kandidatët e interesuar, duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Qendrës për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Lipjanit.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës si dhe në Kolegjet private brenda Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre të jenë të njohura nga MASHT, në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën do të refuzohet çdo aplikacion të cilat nuk e plotësojnë këtë kusht të konkursit.

Njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/lipjan/> dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.

IMRI AHMETI

KRYETAR KOMUNE

